

Nr. prot _____

Për: Z. Sali Berisha
Kryeministër
Këshilli i Ministrave
Tiranë

Nga: Vasilika Hysi
Drejtoreshë Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Tiranë më 10 janar 2008

Lënda: Lidhur me disa shqetësime të dala nga vëzhgimet e fundit të KSHH-së në institucionet e paraburgimit dhe në qendrën spitale të varësi të Drejtorisë së Burgjeve

I nderuar Z. Kryeministër,

Do të dëshironim t'ju vinim në dijeni se, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) ka patur dhe ka në qendër të vëmendjes së tij respektimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të personave të ndaluar, arrestuar dhe të dënuar, në veçanti.

Gjatë muajve nëntor-dhjetor 2007, KSHH-ja ka ndërmarrë disa vëzhgime në institucione paraburgimi dhe burgje përkatësisht në rrethet Berat, Vlorë, Krujë, Kukës, Tropojë, Korçë, Peqin dhe në Spitalin e Burgut, Tiranë. Deri në mars 2008 do të vëzhgohen institucionet e tjera. Vëzhgimet realizohen nga aktivistë të të drejtave të njeriut, ekspertë në fusha të tilla si: drejtësi dhe mjekësi, psikologji dhe punë sociale, të trajnuar në fushë dhe për metodologjinë e vëzhgimeve.

Qëllimi i vëzhgimeve është të shikohet në vend respektimi i standarteve të trajtimit të personave të arrestuar dhe të dënuar, respektimin e të drejtave të tyre në përgjithësi dhe të miturit dhe gratë në veçanti si dhe përmbushjen e rekomandimeve të bëra nga institucionet monitoruese vendase dhe ndërkombëtare, përfshirë Komitetin Europian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruar (CPT).

Si rregull, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, konstatimet dhe shqetësimet e tija ia dërgon drejtuesve të institucioneve të monitoruara, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrit të Drejtësisë. Megjithatë, kemi bindjen se zgjidhja e disa prej shqetësimeve kërkon një angazhim më të madh dhe një koordinim mes disa institucioneve. KSHH-ja është e mendimit se informimi Juaj lidhur me gjëndjen në vendet e paraburgimit është i nevojshëm dhe ka besim se qeveria që ju drejtoni do të kontribuojë në zgjidhjen e tyre.

KShH-ja vlerëson kalimin e sistemit të paraburgimit në varësinë të Ministrisë së Drejtësisë, ndonëse me vonesë. Duke marrë parasysh infrastrukturën dhe kushtet që trashëgojnë institucionet e paraburgimit nga komisaritet e policisë, jemi të vetëdijshëm që ky proces do të shoqërohet me vështirësi. E shikojmë të nevojshme t'ju drejtohem juve jo vetëm për vlerësimin më të madh të këtij problemi, por edhe për dhënien e udhëzimeve përkatëse që secili organ ë kryejë me rigorozitet detyrat e ngarkuara me ligj si dhe ë përmbushë detyrimet që rrjedhin nga Konventat, legjislacioni dhe në mënyrë të veçantë rekomandimet Komitetin European për Parandalimin e Torturës dhe të trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruës.

Gjithashtu, e shohim ë nevojshme që të trajtojmë disa probleme serioze ë cilat kërkojnë vëmendjen Tuaj dhe të drejtuesve të institucioneve të tjera të larta.

1 Trajtimi i personave të sëmurë që kryejnë vepra penale

Gjatë vëzhgimeve, KSHH-ja konstatoi se në Qendrën Spitalore të Burgjeve gjendeshin 83 persona me probleme psikike. Për 73 persona ishte marrë masa e mjekimit të detyruar, ndërsa për 10 persona të tjerë pritej ekspertiza mjeko-ligjore. Kjo qendër nuk ka mundësi për trajtimin e këtyre të sëmurëve, nuk është e specializuar dhe e ngarkuar me ligj ë bëjë trajtimin e të sëmurëve mendorë që kryejnë vepra penale. KShH-ja disa herë ka ngritur si shqetësim mbajtjen e personave me masë mjekësore në këtë qendër, por problemi nuk ka gjetur zgjidhje.

Gjithashtu, ne sektorin e paraburgimit të Institucionit të ekzekutimit të dënimit me burgim Peqin ndodheshin 40 të sëmurë mendore, me diagnoza të ndryshme, përfshirë edhe skizofreni si dhe të sëmurë mosha tejet të vjetra.

Sipas neni 16 të ligjit “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, të sëmurët me masa mjekësore duhet të trajtohen në institucione të specializuara. Në mes ë vitit 2005, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka siguruar ambjente për ngritjen e një qendre të specializuar në qytetin e Durrësit. Ndonëse ka kaluar 2 vjet e gjysëm, kjo qendër ende nuk ka filluar të funksionojë.

KSHH-ja vlerëson rëndësinë dhe domosdoshmërinë e hapjes sa më shpejt të këtij institucioni dhe transferimin në të të personave të sëmurë mendorë që duhet të vuajnë dënimin e dhënë nga gjykata. Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë duhet t'i japin zgjidhje problemit të personave të mitur rën moshën e përgjegjësisë penale që janë të sëmurë mendore, që kryejnë krime të rënda dhe që trajtimi mjekësor i detyruar është e nevojshëm. Ata nuk mund të lihen të lirë, të patrajtuar nga ana mjekësore duke përbërë rrezik për familjarët dhe personat e tjerë, por edhe objekt të stigmatizmit dhe etiketimeve poshtëruese dhe johumane nga të tretët. Lidhur me të miturit që nuk mbushur moshën e përgjegjësisë penale dhe kryejnë një vepër penale është urgjente ngritja e një qendre edukimi.

Për shkak të mbajtjes në spitalin e burgut të personave të sëmurë mendore, kjo qendër ishte e mbipopulluar. Kapaciteti i lejuar në këtë Qendër është 110 persona, në kohën kur është kryer vëzhgimi, ishin të shtruar 130 persona. Mbipopullimi cenon rëndë të drejtat e personave të privuar nga liria dhe që kanë nevojë të trajtohen ose ë kurohen në mënyrë të perkohshme. Shpesh mbipopullimi privon marrjen e shërbimit mjekësor ë specializuar ë personave që ndodhen në institucionet e ekzekutimit ë dënimit me burgim. Nga vëzhgimi u vunë re se 4 persona vuanin nga sëmundje të pashërueshme.

KShH-ja sugjeron trajtim me kujdes të këtyre rasteve nga institucionet përkatëse.

2. Sigurimi i paisjeve mjekësore për qendrën spitalore të burgjeve dhe shërbimet e ofruara nga qendrat spitalore të tjera

Megjithë përpjekjet e bëra nga personeli spitalit të burgjeve, kjo qendër ka nevojë për pajisje dhe aparatura mjekësore që bëjnë të mundur trajtimin e sëmundjeve të ndryshme si: skopi, grafi etj. Gjithashtu, në këtë Qendër duhet të funksionojë laboratorit klinik si edhe shërbimet e urgjencës për të sëmurët me diagnozë hemofili.

Nga vëzhgimi, u njohëm me shqetësimin lidhur me indiferencën e treguar nga ana e repartit të kirurgjisë pranë QSUT-së për t'iu përgjigjur në kohë rasteve të ndryshme të sjella nga Qendra Spitalore e Burgjeve. Ndonëse ligji përcakton se në raste të nevojës për një trajtim të specializuar, ndihma mund të jepet nga një qendër jashtë sistemit të burgjeve, është realizuar me vonesë në disa raste dhe jo në cilësinë e duhur.

KShH-ja sugjeron se duhen marrë masa të menjëhershme për të shmangur këto forma diskriminimi ose indiference që u bëhet personave të privuar nga liria nga shërbimet e spitaleve civile.

3 Shërbimi mjekësor dhe personeli mjekësor në institucionet e paraburgimit

Në institucionet e paraburgimit të Tropojës, Kukësit dhe Vlorë nuk kishte mjekë. Vëzhguesit u njohën me shpjegimin e dhëna nga personeli se në Institucionin e Kukësit se mjeku do të fillonte punë me kohë të plotë në Janar 2008, ndërsa në institucionin e Tropojës, personeli shpjegoi se nuk ka kandidatura të ofruara për këtë pozicion për shkak të pagës së ulët. Gjithashtu në Tropojë, Kukës, Korçë mungonte shërbimi stomatologjik dhe personat e arrestuar duhet të paguan vet shërbimet private dentare.

Për shkak të mungesës së mjekut, stafi i institucioneve të monitoruara nuk ofronte shërbimin e duhur sidomos në raste urgjence dhe ndërkohë krijohen probleme për shëndetin dhe sigurinë në raste kur personat duhet të dërgoheshin në spitalet jashtë qendrës spitalore të burgjeve. Gjatë vëzhgimit u informuam edhe për indiferentizimin e treguar për trajtimin e të sëmurëve në spitalet civile. Pavarësisht nga vështirësitë është detyrë e drejtuesve të institucioneve të gjejnë zgjidhjet e duhura që shërbimi mjekësor në institucion të mos mungojë dhe të jetë 24 orësh ashtu siç e kërkon ligji. Për këtë qëllim, KShH-ja sugjeron se duhet të merren masa të menjëhershme për zgjidhjen e këtij problemi.

Në dy institucionet e paraburgimit Tropojë dhe Kukës mungonin totalisht medikamentet, ndërsa në institucionin e paraburgimit Korçë dhe Vlorë, kishte shumë pak prej tyre, madje më të thjeshtat. Shumica e personave të arrestuar i siguronin mjekimet vet me anë të familjarëve. Kjo gjendje është shkelje flagrante e dispozitave 22-28 të Rregullores së Paraburgimit, por nga ana tjetër mund të çënojë sigurinë dhe jetën e personave të arrestuar. KShH-ja sugjeron marrjen e menjëhershme të masave për të bërë të mundur furnizimin me medikamente mjekësore të këtyre institucioneve, sipas nevojave që ato kanë, bazuar në një vlerësim real, të saktë llojeve të sëmundjeve dhe nevojave për medikament duke mundësuar në këtë mënyrë hartimin e një buxhetimi realist dhe në përputhje me nevojat e secilit institucion.

Gjithashtu, shpërndarja e barnave duhet të bëhet detyrimisht nën kontrollin dhe vëzhgimin e mjekëve.

4. Kushtet fizike dhe higjeno-sanitare në vendet e paraburgimit

Gjendja fizike është shumë e rëndë në të gjitha vendet e paraburgimit të monitoruara. Pajisjet si, çarçafë, dyshekë (në disa vende të vendosura direkt në dysheme, etj). në institucionin e paraburgimit Tropojë, Korçë dhe Vlorë ishin të vjetëruara dhe të papastra. Gjithashtu, shumë kritike paraqitej situata në dhomat e paraburgimeve ku ishin vendosur më shumë të paraburgosur në një dhomë sesa kapaciteti që mund të mbante qelia. Në institucionin e paraburgimit në Tropojë, situata rëndohej në kushtet e reshjeve të borës e të shiut, pasi shiu dhe bora rridhnin brenda dhomave duke shkaktuar lagështi të theksuar me pasoja të dëmshme për shëndetin e personave të paraburgosur.

Si pasojë e mbipopullimit dhe kushteve të rënda fizike, shumë prej personave vuanin nga sëmundje të ndryshme dhe higjiena e tyre ishte jo e mirë. Pothuasje të gjithë personat e arrestuar u ankuan se nuk kanë mundësi të lahen më shumë se njëherë në javë, për shkak të mospasjes së dusheve të mjaftueshme dhe energjisë elektrike.

KSHH-ja sygjeron marrjen e masave për sigurimin e higjienës dhe pastërtisë, krijimin e kushteve mininale për mbajtjen e personave të paraburgosur. Me qëllim që të ulet mbipopullimi, është i nevojshëm koordinimi më i mirë i punës së prokurorisë, gjykatave dhe drejtorisë së përgjithshme të burgjeve për të kontribuar në zhvillimin në kohë të proceseve penale, hetimin e shpejtë të tyre dhe përdorimin më të mirë të mundësive që jep legjislacioni penal shqiptar për një hetim dhe gjykim të shpejtë dhe efektiv të çështjeve penale. Nga ana tjetër, institucionet e paraburgimit duhet të paisen me mjetet logjistike të nevojshme për të ofruar shërbimin e duhur ndaj personave të arrestuar (lëvizjet për në prokurori, gjykatë ose në spital, etj) por edhe për të shmatur zvarritjet e proceseve hetimore dhe gjyqësore për shkak të mungesës së automjeteve ose numrit të kufizuar të tyre.

5. Ushqimi dhe cilësia e tyre

KSHH-ja thekson me shqetësim se në të gjitha institucionet e paraburgimit të vëzhguara (me përjashtim të institucionin e paraburgimit Korçë të cilat janë në ndërtesat e komisariateve të policisë vazhdonte të zbatohet norma e vjetër ushqimore, ndërsa situata ndryshonte në institucionet e paraburgimit të cilat janë pranë burgjeve ekzistuese dhe në institucionet e paraburgimit në Tiranë. Ndonëse, prej korrikut 2007 ka hyrë në fuqi norma e re ushqimore ajo nuk zbatohet. Autoritetet e institucioneve pretenduan se norma e re ushqimore fillon në janar 2008. Për KSHH-në diferencime të tilla janë të papranueshme dhe sugjeron të merren masa të menjëhershme për të mos lejuar të vazhdojë kjo situatë.

6. Respektimi i të drejtave të personave në momentin e arrestimit

Pjesa më e madhe e personave të intervistuar pohuan se në momentin e ndalimit, shoqërimit dhe pyetjes nga policia janë keqtrajtuar dhe nuk janë informuar për të drejtat e tyre. Në shumicën e rasteve të miturit kanë pohuar se nuk kanë patur avokatë dhe janë keqtrajtuar. KSHH-ja ishte në pamundësi të verifikojë këto pretendime për shkak të kohës së kaluar nga momenti i pretenduar për ushtrim dhune. Ndonëse Komiteti European për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruës ka rekomanduar se prokuroria duhet të informohet menjëherë lidhur me keqtrajtimet dhe të monitorojnë pa paralajmërim këto vende, një gjë e tillë u konstatua se nuk duhet të ishte zbatuar rregullisht. Në rrethana të tilla, KSHH-ja sygjeron forcimin e rolit të kontrollit të prokurorit, krijimin e mundësisë për personat që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar dhunë t'i nënshtrohen ekzaminimeve mjekësore dhe kur është rasti personat përkatëse të vihen para përgjegjësisë ligjore.

I nderuar Z. Kryeministër,

KShH-ja shpreson se nën vëmendjen tuaj do të merren masat e nevojshme për të përmirësuar situatën në institucionet e paraburgimit në mënyrë që ato të drejtohen dhe të funksionojnë sipas gjithë standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit shqiptar.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin, mbetemi në pritje të masave që do të merren nga ana qeverisë që ju drejtoni dhe institucioneve përkatëse.

Me respekt,

Prof. as.dr Vasilika Hysi
Drejtore ekzekutive

Për dijeni

Kjo letër i është dërguar:

1. z. Enkelejd Alibeaj, Ministër i Drejtësisë
2. z. Lulëzim Kodra, Zëvendësdirjtor i Përgjithshëm i Burgjeve